

Procedura e kthimit

Procedurë informative dhe mbështetëse për kthimin vullnetar

Kjo fletushkë vlen për azilkërkuesit dhe punonjësit e tyre socialë.



Bëni një kërkesë azili në Belgjikë. Pas marrjes së një përgjigje negative të kësaj kërkesë, ju duhet të mendoni për të ardhmen. Ne mund t'ju ndihmojmë për organizimin e kthimit vullnetar.

Fedasil ofron një procedurë informative dhe mbështetëse, ose e quajtur ndryshe 'procedurë kthimi'. Çdo azilkërkues ndjek një procedurë të tillë. Punonjësi social do t'ju ndihmojë gjatë kësaj procedure.

1. GJATË PROCEDURËS SË AZILIT

Ju informoheni për kthimin vullnetar pasi bëni një kërkesë azili. Megjithatë ju jeni të lire të ktheheni në vendin tuaj në çdo kohë, edhe nëse procedura e azilit nuk ju ka përfunduar.

2. MARRJA E NJË PËRGJIGJE NEGATIVE

Nëse merrni një përgjigje negative (= nëse CGRS¹ nuk ju jep statusin e refugjatit), punonjësi juaj social mendon për mundësitë që keni në të ardhmen, duke përfshirë këtu edhe kthimin vullnetar. Punonjësi social do të komunikojë personalisht me ju.

3. VENDIMI NEGATIV KONFIRMOHET

Pas marrjes së përgjigjes, mund të bëni një ankesë kundër vendimit të marrë nga CGRS. Nëse CCE² refuzon ankesën e bërë, kjo do të thotë që ju jeni në fund të procedurës dhe ju duhet të largoheni nga vendstrehimi i ofruar. Qëndrimi juaj mund të zgjatet vetëm në një **qendër të hapur për kthim**.

¹ CGRS: Komisarati I përgjithshëm i azilkërkuesve dhe personave të pashtet

² CCE: Këshilli i ankesave për të huajt (Council for Alien Disputes)

QENDRAT E HAPURA PËR KTHIM

Qendër e hapur

Vendstrehimet e hapura janë qendra të hapura të ofruara nga Fedasil. Ju mund të gjeni strehim në një qendër të hapur ose të largoheni kur të dëshironi.

30 ditë

Strehimi në një qendër të hapur zgjat 30 ditë. Gjatë kësaj periudhe ju takoheni tre here me asistentin për kthim.

Asistenti për kthim

Keni mbështetjen e një asistenti për kthim, i cili rri në kontakt me ish-asistentin tuaj social. Asistenti për kthim ju informon mbi kthimin vullnetar në vend dhe ju ndihmon të merrni një vendim.

Ndihmë për riintegrim

Gjatë strehimit në një qendër të hapur për kthim, asistenti përkatës do të rishikojë situatën tuaj. Asistenti do t'ju shpjegojë ndihmën që ofrohet për tu rikthyer në vendin tuaj. Kjo ndihmë quhet ndryshe ndihmë për riintegrim në vendin e origjinës.

Zyra e emigracionit

Pas vendimit përfundimtar (të marrë nga CCE), procedura juaj e azilit përfundon. Në qendrat e hapura për kthim gjeni dhe një punonjës të Zyrës së emigracionit i cili mbikqyr rastin tuaj.

Pas 30 ditësh

Pas 30 ditësh strehimi juaj në qendrën për kthim përfundon. Strehimi juaj mund të zgjatet nëse ju jeni duke përgatitur kthimin. Në rast se ju nuk vendosni të ktheheni vullnetarisht dhe nëse nuk largoheni nga qendra, atëherë Zyra e emigracionit mund të kryejë kthimin e detyruar.

KTHIMI VULLNETAR

Ju mund të kërkonti të ktheheni vullnetarisht në çdo moment. Megjithatë ne e kuptojmë që një vendim i tillë nuk është i lehtë dhe për këtë arsye Fedasil është i gatshëm t'ju ndihmojë të gjeni zgjidhje për problemet që mund të keni pas kthimit në vendin tuaj të origjinës.

Kontaktoni **asistentin tuaj social** për më shumë informacion mbi kthimin vullnetar.

Mund të kontaktoni edhe në **numrin falas të telefonit 0800 32 745** (prej orës 9 deri në 5).

Mund të gjeni informacion edhe në qendrat për kthim të Fedasil (në Bruksel, Anvers, Gent dhe Liège) ose në ndonjë prej partnerëve tanë. Adresat përkatëse mund t'i gjeni në faqen e internetit: **www.voluntaryreturn.be**.

Vërejtje:

Edhe nëse nuk jeni më azilkërkues e gjendeni ilegalisht në Belgjikë, ju keni të drejtë të ktheheni vullnetarisht në vendin tuaj.